



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:272737
Datë: 24.10.2024
Numri i dokumentit: 06341868

C-IV-14-5465

Parashtruesi i kërkesës

P S përfaqësuar nga avokat **B I**, Prishtinë.

kundër

Pala kundërshtare

Agjencioni Kosovar i Privatizimit- AKP (NSH “Klina” në likuidim), Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishte, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 24 tetor 2024 lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- I. Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.**
- II. Refuzohet kërkesa e përfaqësuesit të ankuesit mbi bashkimin e lëndëve.**
- III. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PEJ138-0249 datë 18 qershor 2014.**
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 21 korrik 2014, përfaqësuesi i ankuesit ka parashtruar kërkesa për rishikim të Vendimeve të Autoritetit të Likuidimit, ndaj NSH “Klina”, për gjithsejtë 10 (dhjetë) ankues.

Kërkesat nga zyra e Regjistrit të DHPGJS janë regjistruar individualisht për secilin ankues veçmas.

Sipas kërkesës, së ankuesit P S, kërkesa për rishikim të Vendimit të Autoritetit të Likuidimit, është regjistruar dhe evidentohet sipas lëndës C-IV-14-5465.

Ankuesi, pranë DHPGJS, me kërkesën e tij, të emërtuar ankesë, kërkoj rishikimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) PEJ138-0249 datë 18 qershor 2014 (në tekstin e mëtutjeshëm Vendimi) me të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensimin pagave të papaguara në shumë prej 13,392.00 (një tre tre nëntë dy zero) Euro dhe kontributeve pensionale në shumë prej

1,392.80 (një tre nëntë dy zero) Euro për periudhën prej datës 1 janar 1990 gjer 1 korrik 1999, e në shumë totale prej 16,843.20 (një gjashtë tetë katër tre dy zero) Euro, përfshirë edhe kamatën ligjore prej 10%, kërkesa këto ndaj NSH “Klina” (në likuidim).

Ankuesi fillimisht pohoj se ishte i punësuar pranë NSH gjer në vitin 90’ kur si rezultat i masave të dhunshme e diskriminuuese, ashtu si edhe punëtorët tjerë, ishte larguar nga puna nga organi i përkohshëm punë-drejtues. Ankuesi tutje pohon se pavarësisht se kanë ushtruar të drejtat e tyre në Gjykatën e punës së bashkuar këto gjykata kanë pushuar së ekzistuari dhe lëndët janë bartur në gjykatat e rregullta e në qytete të ndryshme të Sërbisë. Me këtë veprim ankuesi konsideron se i është mohuar e drejta e tij.

Ankuesi tutje pohoj se AL u ka thënë punëtorëve se të gjitha kërkesat për paga do të trajtohen në procedurë të likuidimit të NSH me çka është vënë në lajthim sepse nuk ka iniciuar procedurë gjyqësore.

Përfaqësuesi i ankuesit tutje kërkoj që të gjitha kërkesat e ankuesve 9 (nëntë) të bashkohen në një të vetme me arsye se është ndaj së njëjtës NSH dhe bazë të njëjtë dhe nga i njëjti përfaqësues.

Ankuesi kundërshtoj Vendimin e AL duke e konsideruar si një formë-formular të shumëzuar në qindra kopje dhe e paarsyetuar, me çka ankuesit i vështirësohet realizimi i të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

Përfaqësuesi i ankuesit tutje kundërshtoj Vendimin e AL, lidhur me parashkrimin ashtu që konsideron se Ligji për Punën e bashkuar – LPB i aplikuar nga ana e AL, është ligji i shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit mbi ndërmarrjet (gazeta zyrtare RSFJ nr. 77/88).

Përfaqësuesi i ankueses përfundimisht konsideron se ankuesit, në pajtim me dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2001/27 dhe 2005/48 respektivisht Ligjit të punës, i takon kompensimi mbi pagat e pa-paguara.

Nga gjitha arsyet, propozon gjykatës që të aprovon kërkesën e ankuesit si të bazuar.

Kërkesës për rishikim i janë bashkangjitur:

- Kopja e Autorizimit për përfaqësuesin,
- Kopja e deklaratës, e dorë-shkruar, dhe
- Kopja e Vendimit të AL.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 9 shtator 2022 parashtrorj përgjigjen.

AKP kundërshtoj ankesën si të pabazuar. Sipas AKP AL me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e ankuesit, ka bërë një vlerësim të saktë dhe njëherit ka vendosur në mënyrë të drejtë. AKP tutje pohon se ankuesi nuk ka ofruar argumente ligjore, në favor të ankesës së tij, ashtu siç parashihet sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP lidhur me dispozitat ligjore të Ligjit për DHPGJS. AKP përfundimisht pohon se kërkesa kreditore e ankuesit konsiderohet e parashkruar në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për punën e bashkuar-LPB. Nga gjitha arsyet propozoj që kërkesa për rishikim të hedhet si e papranueshme ose refuzohet si e pabazuar dhe Vendimi i AL të vërtetohet.

Përgjigjes i është bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL-së.

Përgjigja e AKP me anë të urdhrorit të gjykatës ju dorëzua përfaqësuesit të ankuesit me 16 shtator 2022.

Nuk u parashtrua përgjigje.

Arsyetimi ligjor

Kërkesa për rishikim-ankesa konsiderohet e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit për DHPGJS (ligji nr.06/L-086) në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Kërkesa për bashkim të lëndëve

Kërkesa për rishikim-ankesat e 9 (nëntë) ankuesve pranë DHPGJS janë regjistruar si kërkesa – ankesa individuale dhe sipas regjistrorit të gjykatës kërkesa e çdo ankuesi përmban numër individual. Me rastin e verifikimit pranë zyrës së regjistrorit të gjykatës, si shembull lënda e ankueses C G, njëra nga 9 (ankuesit) mban numrin C-IV-14-5469, ankuesja F S, po ashtu njëri nga 9 (nëntë) ankuesit, lënda evidentohet si lënda C-IV-14- 5472. Këto lëndë tani më janë në fazë të avancuar të procedurës të zhvilluar nga gjyqtarët e çështjes gjersa lënda-kërkesa e ankuesit F S tani më është vendosur nga gjyqtari i çështjes, me Aktgjykimin datë 22 gusht 2024.

Andaj nga këto arsye, gjykata konsideron se nuk janë plotësuar kushtet ligjore mbi bashkimin e lëndëve, ashtu siç parashihet sipas nenit 41.1 i Ligjit për DHPGJS (ligji nr. 06/L-086).

Për më tepër neni si më lartë i cituar i Ligjit për DHPGJS lejon edhe ndarjen e lëndës. Aty thuhet se: *“para nxjerrjes së një Aktgjykimi për të gjitha kërkesat/ ankesat që do të bashkohen, mund të ndahet çfarëdo kërkesë/ankese për të cilën nuk është nxjerrë një Aktgjykim.”* Dispozitë e ngjashme ishte edhe dispozita e nenit 33.1 të Ligjit të mëparshëm të DHPGJS (ligji nr. 04/L-033) ligj ky në fuqi me rastin e parashtrimit të kërkesës për rishikim-ankesës.

Nga gjitha arsyet gjykata vendosi si në pikën 2 të dispozitivit.

Kërkesa për paga të pa-paguara - 1 janar 1990 gjer 1 korrik 1999

Në rastin konkret bazuar sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast ankuesit, që në parashtrësit e tij me shkrim, ankesën, të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsytimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e tij. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast ankuesi, të ekzistojë një fakt, ajo palë është i obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.

Nga dispozita e cekur si më lartë, është obligim i ankuesit që të dëshmoj detyrimet ndaj tij, mbi mos pagesën e kompensimit të ardhurave personale.

Kërkesa e ankuesit për kompensimin e pagave i takon periudhës së viteve 1 janar 1990 gjer 1 korrik 1999 kur edhe ankuesit i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe se ashtu siç e cek tani i njëjti nuk ka pasur mundësi të zhvilloj procedura gjyqësore në atë periudhë.

Ky qëndrim i ankuesit, mbi pamundësinë e zhvillimit të procedurave gjyqësore, gjykata e konsideron si të paqëndrueshëm në aspektin ligjor.

Fillimisht ankuesi nuk ka parashtruar ndonjë Vendim mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, referuar viteve 1990 -1999. Tutje, sikur edhe të ekzistonte një Vendimi tillë, ankuesi do të duhej pavarësisht pohimeve të tij të zhvillonte procedura ligjore, si ajo e kundërshtimit - ankesës të Vendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës pranë NSH dhe përfundimisht padia e dorëzuar pranë Gjykatës kompetente, mundësi këto ligjore të parapara sipas Ligjit mbi marrëdhëniet e punës (gazeta zyrtare e KSAK nr. 14/89) dhe më vonë sipas Ligjit mbi marrëdhëniet e punës (gazeta zyrtare e RS 45/91) i cili ligj shfuqizon Ligjit e marrëdhënies së punës së Kosovës.

Lidhur me pagat e papaguara si dhe kompensimit, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 dhe 1.6.2 parashihet:

- a. përmbushja e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person, si dhe
- b. e drejta në kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në .

Tutje sipas nenit 40 paragrafi 1.7, të shtojcës së Ligjit për AKP, parashihet përmbushja e kërkesave siç janë: “kërkesat e pasiguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë”.

Nga dispozitat e lartëcekura, mund të konkludohet se, punëtori/ja gëzon të drejtën në paga respektivisht dëmshpërblim nëse:

- a. pagat e punonjësit, në këtë rast ankuesit, nuk janë paguar;

Andaj nga të gjitha arsyet e cekura si më lart ankuesi nuk ka dëshmuar të drejtën e tij mbi kompensimin siç edhe parashihet sipas nenit 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 dhe 1.7 por edhe nuk ka dëshmuar ndonjë obligim tjetër ashtu siç parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS

Kërkesa për pagesën e kontributeve pensionale

Subjekti tatimor versus Administrata tatimore

Për më tepër, pavarësisht Vendimit të AL dhe pohimeve të AKP në përgjigje, sipas Ligjit për tatimin në të ardhurat personale (LIGJI nr. 3/L-0161) ligj ky në fuqi me rastin e lëshimit të Vendimit nga ana e AL, si dhe Ligjit për Fondet pensionale në Kosovë (LIGJI Nr. 04/L-101), subjekt i obligimit tatimor duhet të jetë NSH “ Klina”. Kjo për faktin sepse ankuesi pretendon të drejtën në pagesën e kontributeve pensionale, si ish punëtor -i punësuar pranë NSH.

Administrata Tatimore e Kosovës – ATK, në rastin kur një subjekt tatimor, si në rastin konkret NSH “Klina”, konstaton se nuk ka kryer obligimet tatimore, si ato të tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) në furnizimet e brendshme; Tatimit në Ardhurat Personale; Tatimit në të Ardhurat e

Korporatave; Tatimet e mbajtura në burim dhe Kontributet Pensionale, sipas autorizimeve të saj të dhëna sipas Ligjit mbi procedurën tatimore dhe procedurat (Ligji nr. 03/L-222) ushtron kompetencat e saj ligjore ndaj subjektit tatimor, në këtë rast NSH, dhe kërkon përmbushjen e obligimeve të papaguara tatimore, të cekura si më lartë, me kërkesë drejtuar AKP si administruese e NSH.

Në rastin konkret, ATK në rastin kur konstaton mos pagesën e kontributeve pensionale, duhet ti drejtohet AL me kërkesë mbi përmbushjen e të gjitha obligimeve si ato tatimore por edhe pensionale të papaguara të një subjekti, në këtë rast NSH “Klina”, përfshirë edhe pagesën e tatimeve në paga, të papaguara, të gjithë punëtorëve në shkallën e përcaktuar (neni 6 i Ligjit për tatimin në të ardhurat personale) apo pagesën e kontributeve pensionale, të gjithë punëtorëve të punësuar (neni 6 i Ligjit për fondet pensionale në Kosovë).

Nga gjitha arsyet, e dhëna si më lartë, gjykata konsideron se në këtë rast subjekti i përmbushjes së obligimeve tatimore është NSH, por me kërkesë drejtuar nga administrate tatimore, ATK, gjersa përmbushja e obligimeve është obligimi i AL – respektivisht AKP si administruese e NSH (Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit me Shtojcën e saj).

Nga gjitha arsyet u vendos si në pikën 3 dispozitivit.

Taksat gjyqësore

Ankuesi ka paguar taksat gjyqësore.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, gjykata vendosi që secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar